



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Procesverbal

Nga seance e dhjetë (X) e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur më 29.12.2015 me këtë:

Rend pune:

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar
2. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa**
 - 2.1- Kërkesë për ndryshimin e projektit për rregullimin e shtratit të Lumit Mirusha
 - 2.2. Projekt – rregullorja mbi taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale për vitin 2016
 - 2.3. Plani – operativ emergjent për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera
 - 2.4. Kërkesë për financimin e Manifestimit Mbarëkombëtar “Flaka e Janarit” 2016
3. Të ndryshme

Në seancën e dhjetë (X) të Kuvendit të Komunës morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri

Zv/kryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu

Përfaqësuesja e OSB-së, Sadete Ternava

Përfaqësuesi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, Shaban Terziu

Mediet

Seancën e dhjetë e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesja e Kuvendit, zonja Valentin Bunjaku-Rexhepi e cila fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë ata që i monitorojnë punimet e seancës së dhjetë.

Në vijim të punimeve të seancës, kryesuesja e kërkoi që fillimisht të aprovet procesverbali i seancës së kaluar, prandaj nëse ka ndonjë vërejtje mund ta thoni?

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar

Procesverbali

Nevzad Isufi- në faqen 7 në pasuesin e tretë është lëshuar një gabim teknik sepse thuhet nga perimet, prandaj duhet të jetë nga (**parimet**)

Në faqen 14 duhet shtuar edhe këtë fjali:” nga mosrespektimi i Planeve urbanistike dëmi është më madh se sa dobia që sjellin parat e grumbulluara gjatë këtij viti”.

Aprovohet procesverbali me këto dy vërejtje të z. Isufi.

Në punimet e seancës së dhjetë ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit

Valentin Bunjaku-Rexhepi- rendin e punës e keni marrë, por grupi punues i Planit të punës së Kuvendit është takuar dhe jemi pajtuar që të futet edhe kjo pikë e rendit të punës në këtë seancë. Kjo është një pikë shtesë, prandaj po e hapi debatin për pikat e rendit të punës.

Sahit Abazi- si grup i PDK-së jemi për këto pika të rendit të punës, por kemi propozim edhe për pika të tjera dhe njëra ndër ato që kërkojmë që të debatohet është ajo e cila është bërë aktuale është ajo për çështjen e anëtarit të Kuvendit nga komuniteti serb. Z. Sergjan Mitroviç në të njëjtën kohë është edhe kryetari i Komunës (paralele) serbe të Gjilanit, prandaj kërkojmë që kjo çështje të vihet në rend të punës për debat. Ne si PDK këtë rast e konsiderojmë si ndërhyrje në punët e brendshme të Republikës së Kosovës nga ana e Serbisë.

Ne duhet të diskutojmë tash dhe si Kuvend ta marrim një qëndrim, sepse ky zotëri nuk mundet në të njëjtën kohë ta përfaqësojë komunitetin serb në institucionet e Kosovës, kurse në anën tjetër të jetë edhe kryetar i një institucioni paralel, sepse dihet se Kosova për 15 vjet ka pasur vuajtje të mëdha ka pasur nga këto struktura paralele. Ne kërkojmë shoqërisht dhe miqësisht që kjo të jetë temë e përbashkët e jona dhe nuk po kërkojmë ndonjë dënim ekstrem për Segjanin, por po kërkojmë që Sergjani t’i respektojë institucionet e shtetit tonë. Kjo duhet të jetë si pikë e parë e rendit të punës, sepse nuk mundemi edhe më tutje të nëpërkëmbemi dhe nuk mund të lejojmë që dikush të jetë edhe në ekipin tonë e që është ekip integruese dhe nuk është përjashtuese dhe në anë tjetër të jetë edhe pjesë e një ekipi i cili për 15 vjet e ka dëmtuar Kosovën, por më së tepërmi e ka dëmtuar komunitetin serb që jeton në Kosovë. Unë kërkoj që kjo duhet të jetë pikë e parë e rendit të punës!

Valentinë Bunjkau- Rexhepi- z. Sergjani për ne është vetëm një anëtar i Kuvendit për ne, kurse ato struktura për të cilat po flet z. Abazi nuk kemi as çka të debatojmë?

Renan Imami- kërkoj që drejtori i Arsimit të na informojë përkitazi me vizitën e tij në Turqi?

Selami Xhemajli- unë po ndërlidhem me diskutimin e kolegut nga PDK-ja përkitazi me çështjen e z. Sergjan Mitroviç, sepse kanë qarkulluar lajme se është zgjedh kryetari strukturave paralele të Komunës së Gjilanit, prandaj unë kërkoj që së pari z. Mitroviç të deklarohet vetë se a është i vërtetë ky lajm apo jo? Ne një akt të tillë e dënojmë, sepse është në kundërshtim me ligjet e Komunës së Gjilanit dhe Republikës së Kosovës, sepse ai mandatin e ka fituar që t’i mbrojë interesat e komunitetit serb në KK të Gjilanit, por ai deri më tash asnjëherë nuk ka shpreh asnjë kërkesë, reagim apo shqetësim për gjendjen e komuniteti serb, kurse në anën tjetër zgjidhet kryetar i Komunës paralele të Gjilanit.

Unë propozoj që të deklarohet, kurse unë e përkrahi çdo iniciativë për shkarkimin e tij, sepse mënyra e shkarkimit të tij përcaktohet sipas LVL. Nëse ky zotëri ka pak dinjitet duhet vetë të jap dorëheqje si anëtarë i Kuvendit nëse nuk i përfill ligjet e Republikës së Kosovës, por duhet edhe ta dijë se ëndrrat e tij për Serbinë e Madhe kanë përfunduar në vitin 1999. Unë nuk mund ta pranojë këtë person si koleg i yni nëse në një anë është anëtarë i KK-së Gjilanit, kurse në anën tjetër i mbron interesat e shtetit paralele të Serbisë në Kosovë. Unë kërkoj që nëse qëndron ajo që po thuhet se është zgjedh kryetar paralel i Komunës së Gjilanit, të jap dorëheqje nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Gjilanit.

Nevzad Isufi- edhe unë i bashkëngjitëm dy propozimeve të kolegëve nga dy partitë e tjera, sepse në radhë të parë duhet ditur që z. Sergjan Mitroviç është i biri i Bozhidar Mitroviçit, me nofkën Shandori i cili pas viteve të 90 në kohën e okupimit ka qenë kryetari i Komunës së Gjilanit, me vendim të pushtetit të atëhershëm serb, por pa pëlqim dhe vullnet të shumicës shqiptare të Komunës sonë. Sergjan Mitroviçi në zgjedhjet e vitit 2013 është zgjedhur si anëtar i Kuvendit të Komunës i cili këtë detyrë dhe deri më sot e ushtron. Mirëpo emërimi i tij si kryetari i Komunës paralele Serbe të Gjilanit paraqet vepër penale dhe duhet të ndiqet nga Prokuroria e Shtetit, sepse ky emërim është në kundërshtim me sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Askush nuk mundet të jetë përfaqësues i zgjedhur i dy shteteve njëkohësisht, as i pakicës as i shumicës apo ndonjë minoriteti tjetër. Për këto gjëra organet tona të drejtësisë nuk po veprojnë, prandaj kjo është skandaloze, sepse në një shtet të vetëm nuk mund të ketë dy juridiksione dhe dy kushtetuta. Kjo është një përpjekje për të ndërhyrë në shtetin tonë dhe atë jo vetëm në Veri të Mitrovicës, por edhe në këtë pjesë të Anamoravës, jo vetëm ilegalisht, por tash edhe legalisht. Kjo është e papranueshme dhe nuk duhet të lejohet as nga strukturat shtetërore, por as nga ne si Kuvend. Këto janë përpjekje për ta përjetësuar “Zajednicën” ende pa përfunduar konstituimi i saj, prandaj me të drejtë jemi kundër këtyre organizatave të cilat kanë për qëllim zhbërjen e Shtetit të Kosovës. Këto struktura dikush nuk dëshiron t’i shoh si të tilla dhe t’i njoh si të tilla edhe pse çdo ditë faktohen në shumë mënyra dhe një nga mënyrat është edhe kjo. Për këtë arsyeje ne kërkojmë shkarkimin ose dorëheqjen e këtij zotërie, sepse është zgjedhur përfaqësues i komuniteti serb për t’i përfaqësuar në KK të Gjilanit, por në të njëjtën kohë edhe i zgjedhur nga strukturat paralele nga përfaqësuesit e Serbisë në organet tona shtetërore. Tjetër vërejtje kam për pikën 2.3 të renit të punës për të cilën pikë edhe në KPF kam propozuar që kjo pikë të shtyhet për shkak të materialit voluminoz prej 330 faqeve e të cilat faqe është vështirë të analizohen për një kohë të shkurtër.

Gjithashtu është e mirë që na ka ardhur plani i punës për vitin e ardhshëm, por edhe kjo është bërë me shkelje ligjore, sepse nuk ka kaluar në KPF dhe materiali është dërguar me vonesë si gjithëherë.

Valentinë Bunjkau- Rexhepi- kërkesa e z. Isufi për shtyrje të pikës 2.3 ka qenë edhe në KPF, prandaj nëse Kuvendi vendos për ta shtyrë ne e propozojmë për seancën e radhës.

Bujar Nevzadi- unë mendoj pak më ndryshe se kolegët që biseduan për çështjen e Sergjanit, sepse Komuna e jonë vazhdimisht e kemi thënë se kemi qenë pa kryetar, kurse tash janë bërë dy kryetarë!? Ndoshta mungesën e kryetarit Haziri, po e zëvendëson Sergjani dhe më duket se që nga dy seancat që e ka kuptuar, kryetari Haziri se u emërua edhe një kryetar dhe ka filluar të vijë në seanca dhe ndoshta i bën dobi kjo dhe kryetari Haziri po prezanton në seanca, sepse ndoshta po frikohet se po i zënë vendin Sergjani.

Këtë që e thash e pata më tepër për shaka, por unë mendoj se duhet të deklarohet Sergjani se a është anëtar i Kuvendit dhe a është kryetar i strukturave paralele dhe nuk duhet të fillojë seanca për pa u deklaruar ky zotëri. Nëse është kryetari i strukturave paralele, ky duhet ngadalë të ngritët dhe ta lëshojë seancën dhe të shkojë atje ku ka marrë detyra të reja.

E dyta kërkoj nga kryetari që para se të fillojë seanca të na njoftojë për vizitën të cilën e ka pasur në Kanadë.

Avdyli Aliu- në emër të grupit të LDK-së duhet të vazhdomë me këtë rend punës, ta miratojmë këtë rend të punës dhe t’i trajtojmë këto çështje të cilat janë në interes të qytetarëve. Mos të merremi me gjëra që nuk i shohim, por dikush i sheh dikush jo, por nëse dikush e pranoi për kryetar personin e cituar nga disa anëtarë i qoftë për hair, kurse ne nuk e pranojmë dhe thjeshtë nuk e diskutojmë atë çështje. Kemi pasur zgjedhje të lira të cilat janë organizuar në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe i apostrofuari deri më tash në emër të asaj kushtetute dhe atyre ligjeve ka marrë pjesë dhe përball tij qëndron kryetari i Komunës së Gjilanit i cili është zgjedhur me votë të lirë dhe është kryetari i Komunës

dhe është kryetari i banorëve të Gjilanit. Qytetarët nuk njohin kryetar tjetër dhe nuk dinë, por ndoshta është inspiruar edhe prej punës së kolegëve këtu. Kur dikush thotë nuk i njoh institucionet e Kosovës, nuk i njoh edhe dokumentet e Republikës së Kosovës ndoshta dikush edhe është inspiruar në atë aspekt. Para tij (të apostrofuarit) qëndron kryetari i Komunës së Gjilanit dhe thjeshtë kjo është një fantazmë, por ne nuk besojmë në fantazma.

Bajram Hasani- ju e dini se çështjen e bashkësisë së komunave me shumicë serbe e kemi ngrit shumë herët “Zajednicën” dhe demarkacionin me Malin e Zi për të cilin rast është një reagim i madh nga qytetarët edhe në Gjilan dhe në tërë Kosovën. Kemi arrit që ta ngrisim këtë çështje dhe në fund gjykata kushtetuese të merr një vendim i cili do ta stoponte përfundimisht krijimin e “Zajednicës”.

Ne sot jo rastësisht sot kemi menduar ta ngrisim si çështje, sepse po këto që i ka bërë seanca para të sotmes një pjesë e ka bërë Gjykata Kushtetuese dhe po e presim edhe ngritjen e Komisionit nga Presidentja për demarkacionin me Malin e Zi. Mua sot nuk më habit as rasti i Sergjanit duke i menduar edhe zhvillimet në vend, sepse zv/kryeministri serb i Republikës së Kosovës thotë se ne nuk do ta bëjmë ushtrinë e Kosovës. Lirisht mund të thuhet se këtu ekzistojnë strukturat paralele, por Sergjani duhet të deklarohet se a e njeh Republikën e Kosovës dhe a e njeh KK të Gjilanit dhe të qëndrojë si anëtar i Kuvendit nëse nuk i njeh, lirisht të del nga salla, sepse ky nuk mund të qëndrojë si anëtar i Kuvendit. Të deklarohet haptas se a i njeh institucionet e Kosovës apo jo? Në të kundërtën e ka rrugën e hapur dhe të shkojë në Nish apo Beograd apo ku të dëshirojë në Serbi, sepse në Gjilan dhe në Kosovë nuk ka vend!?

Riad Rashiti- unë e kam vetëm një kërkesë shtesë që të deklarohet edhe kryetari i Komunës përkitazi me këtë temë (Sergjanit) si mendon ai dhe sipas informacioneve Sergjani nuk është kryetari i Komunës së Gjilanit, por është kryetari i Qarkut të Gjilanit dhe kjo i bie se është pozitë më e lartë se kryetarit të Komunës sonë, kërkojmë sqarim për këtë çështje?

Mirëpo i kam edhe dy –tri çështje dhe e para është për buxhetin e Komunës së Gjilanit për vitin 2016, sepse sipas raporteve zyrtare që ekzistojnë, Komunës së Gjilanit po vazhdon t’i zvogëlohet buxheti nga viti në vit.

Buxheti për investime kapitale i vitit 2014 ka qenë 3.1 milion €, vitin e kaluar kanë qenë 1.2 milion €, kurse këtë vit i kemi 0.9 do të thotë vetëm 900 mijë €, buxheti i Komunës dhe mos t’i ngatërrojmë grandet prej ministrive.

Kemi 2.2 milion € buxhet për investime kapitale që është ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

A është shqetësuese, z. Kryetar për juve apo jo?

Çështja e dytë është te prokurimi e kemi ngrit edhe në publik, sepse kanë ndodhur skandal pas skandali në prokurim për të cilin departament ju jeni përgjigjes. Ju në prokurim e keni vendos një person i cili nuk e di si është duke menaxhuar, por shifrat janë alarmuese për tenderët të cilët po epen në këtë Komunë. Fakti që OSHP i anulon 21 tender në Komunë të Gjilanit në vlerë prej 4 milion € gjatë këtyre dy viteve është alarmuese edhe për ju z. Kryetar. Vetëm Agjensioni Kundër Korrupsionit 4 tenderë i ka anuluar! Pse po ndodh ko? Ne e dimë pse, por po kërkomë përgjigje nga ju z. Kryetar.

Vetëm këtë muaj janë dhënë tenderë të çuditshëm dhe të pakapshëm por të trurin tonë, personalisht po deklarohem. Ne kemi qeveris për 6 vite, por asnjëherë nuk ka ndodhur të epet tender për mirëmbajtje të rrugëve në vlerë prej 600 mijë € dhe kjo nuk ka ndodhur që 10 vjet që nga pas lufta. Me këtë shumë 596 mijë €, shtrohet një rrugë e madhe dhe me shumë km, kurse ju qeverisja e Gjilanit keni dhënë tender 596 mijë € për 475 mijë € më shtrenjtë se në vitin e kaluar e të cilin ju e keni dhënë edhe vitin e kaluar, asaj kompanie, por edhe këtë vit asaj kompanie për të njëjtin projekt dhe për të njëjtin qëllim dhe është rrit shpenzimi për 475 mijë €. Te mirëmbajtja dimëror e rrugëve vitin e kaluar janë shpenzuar 12 mijë e 550 €, këtë vit keni dhënë tender mbi 124 mijë €, do të thotë për 116 mijë € më tepër se vitin e kaluar.

Te transporti i nxënësve ne në qeverisjen tonë kemi dhënë tender mbi 269 mijë € për tri vite, por kur jeni ardhur në pushtet ju zv/kryetari na ka akuzuar rëndë se gjëja ne kemi bartur nxënës për pa pasur nevojë

me akuza të ndryshme me shumë se 4 kam më afër se 4 km etj. Tanë vitet është llogarit (kërkoj falje në shprehje) për shpenzimet gjëja se kanë qenë të mëdha. Këtë vit i keni dhënë 412 mijë €, tender për tri vite, do të thotë për 142 mijë € më shtrenjtë se qeverisja e jonë.

Lidhur me këtë ka dalim të madh në çmim të naftës dhe në qeverisjen tonë ka qenë 1.4 €, kurse tash është 0.9 €. Në vend se të ulen shpenzimet ju i keni rrit dhe e keni dëmtuar buxhetin shumë rëndë.

Te pastrimi i objekteve shkollore ne kemi pasur kontratë 257 mijë €, për tri vite të ndarë në loto, kurse këtë vit keni dhënë tender 415 mijë €, do të thotë 158 mijë € më tepër se kontrata e kaluar. Te servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve ka qenë 9500 €, kontratë me kuotim, kurse tash është mbi 44 mijë €.

Te dezinfektimi që vetë e ka pranuar kryetari i Komunës, ne për dy vite i kemi shpenzuar 6-mijë deri në 7 mijë €, kurse ju keni dhënë tender 160 mijë €, do të thotë 139 mijë € më shumë se ne që kemi shpenzuar.

Thënë shkurt ju keni lidhur kontrata më të shtrenjta për 1 milion e 32 mijë €. Për këtë arsyeje kërkoj përgjigje se çka po ndodhë me prokurimin në Gjilan duke pasur edhe nj fakt shumë interesant që për këto vite keni dhënë tender 2 milion € për kompani jashtë Gjilanit, kur ne ende vazhdojmë të akuzohemi se jabanxhiu ka marrë punë në Gjilan, kurse ju z. Kryetar i keni dhënë 2 milion €, kompanive jashtë Gjilanit dhe ajo që është më e keqja i keni dhënë 9 tender me kuotim pa kontratë të hapur e që kjo është për të dyshuar, sepse këtu ka plotë keqpërdorime të mëdha ?

Pika e tretë është se uzurpimet e pronës publike po vazhdojnë të ndodhin në qytet edhe nëpër fshatra, prandaj kërkoj sinqerisht ta ndalni këtë dukuri, sepse është e dëmshme për ju dhe për qytetarët e Gjilanit dhe hapësirat publike që janë pronë e Komunës së Gjilanit. Mos lejoni dhe duhet t' i ndaloni urgjentisht uzurpimet që po ndodhin!?

Kemi informacione se edhe Këshillat e Fshatrave po ndajnë hise të pronës publike me miratim në heshtje të zyrtarëve të lartë të Komunës së Gjilanit. Këshillat e Fshatrave nuk kanë të drejtë të ndajnë pronë publike për ndërtimin e shtëpive.

Unë i kam bërë kërkesë edhe kryesues që këtë dukuri ta ndalin menjëherë.

Ndërtimet pa leje vazhdojnë dhe ne e kemi debatuar edhe në seancën e kaluar dhe gjendja është kaotike të cilën gjendje ne e quajmë krim urbanistik, sepse në rastin e Dardanisë janë rikthyer ndërtimet e larta nga investitorë të ndryshëm.

E fundit është se çka po ndodh me rrugën prej rrugës Malishevës me katër korsi derti te Bunari i Perlepnicsës, sepse ne realisht nuk e dimë cili është projekti, sepse ai projekt nuk është prezantuar askund!? Projekti ka ndryshuar shumë, por ne nuk jemi njoftuar. Për të gjitha këto pyetje kërkoj përgjigje nga kryetari i Komunës?

Fehmi Sylejmani- edhe unë i bashkëngjitëm disa mendimeve të parafolësve rreth anëtarit të Kuvendit z. Sergjan Mitroviç dhe mendoj se ajo që u tha deri më tash dhe propozoj që mos të fillojë kjo seancë dhe nuk duhet të injorohen dhe nuk duhet të anashkalohen gjërat të cilat po duken. Edhe më parë është thënë se çështja e “Zajednicës” dhe Pakoja e Ahtisarit nuk janë asgjë, por sot po përballemi dhe po i shohim pasojat e tyre. Nuk jemi si person kundër z. Mitroviçit, duhet ta kuptojë ai, por, jemi kundër politikës nëse ky i bindet dhe vepron në bazë të politikës së Serbisë

Si çështje tjetër kërkoj nga kryetari që Njësia e Auditimit , t' i jep llogari vetëm kryetarit dhe unë i kam kërkuar disa pyetje me shkrim dhe kërkoj që ato pyetje të na epen me shkrim këtu në Kuvend?

Po ashtu kërkoj përgjegjësi për anulim të tenderëve nga Njësia e Prokurimit, sepse anulohen 21 tenderë dhe nuk jep askush llogari, atëherë këtu është diçka shumë shqetësuese. Në sport një ndeshje nëse humbet bëhet një analizë, kurse në këtë rast 21 tender janë anuluar dhe askush nuk jep llogari, prandaj dikush është fajtor dhe duhet të jep llogari.

Po ashtu i bashkëngjitëm parafolësve që kryetari të jep një informatë për vizitën në Kanadë, sepse është përfol shumë në media për këtë vizitë. Po ashtu kërkoj një informatë nga DKA për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë e cila çështje ka qenë deshtë të jetë në rend të ditës.

Kam një pyetje për kryetarin, sepse në disa komuna të Republikës së Kosovës në shumicën e objekteve shkollore janë vendosur kamerat për vëzhgim e të cilat qëllim e kanë rritjen e efikasitetit të sigurisë dhe mbikëqyrjes së objekteve brenda dhe jashtë. Pyetja e ime është se a e ka ndërmend që Komuna e Gjilanit që të vendos kamera nëpër shkolla ?

Mandej sipas informatave Policia e Kosovës ia ka ofruar kryetarit të Komunës, kamerat për vendosje në vendet kyçe të qytetit, prandaj pyetje e ime është se çka është ndërmarrë lidhur me këtë projekt?

Leonorë Bunjaku- duke pasur parasysh gjendjen aktuale në Komunën e Gjilanit e siç është ajo e kryetarit paralel, mandej rregullimi i shtratit të Lumit Mirusha dhe shkalla e lartë e papunësisë, ndërtimi i objekteve pa leje, por si problem kryesor e shohim edhe problemin e ujërave të zeza me të cilin problem qytetarët e Komunës sonë ballafaqohen çdo ditë e në veçanti kur të reshurat janë më të mëdha. Mirëpo në seancën e fundit kryetari na ka premtuar se do të na e sjell edhe Marrëveshjen të cilën e ka nënshkruar me një OJQ apo Qeverinë Austriake. Deri ku është arrit me këtë marrëveshje, sepse sipas planifikimit të buxhetit për vitin 2016 janë paraparë vetëm 80 mijë € për rregullim të infrastrukturës nëntokësore?

Pyetja është a mjafton kjo shumë dhe a ka mundësi për ta sjell atë Marrëveshje dhe të informohen qytetarët se ky problem do të zgjidhet së shpejti, sepse është problem i rëndë me të cilin qytetarët ballafaqohen çdo ditë?

Sa i përket çështjes së Arsimit edhe unë pajtohem me z. Sylejmani, sepse ka qenë deshtë të jetë një raport përkitazi me suksesin dhe sfidat me të cilat është ballafaquar arsimi gjatë këtij gjysmë vjetori.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- sa i përket Raportit për Arsimin është në plan të punës në muajin janar dhe ka qenë deshtë të lexohet plani i punës.

Si kërkesë tjetër nga grupi i LVV ka propozuar që pika 2.3 të hiqet nga rendi i punës për shkak të volumit të madh të materialit, prandaj iu lus që kush është që të hiqet nga rendi i punës pika 2.3.

Aprovohet kërkesa e LVV dhe hiqet nga rendi i punës pika 2.3: Plani – operativ emergjent për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, 12 ishin kundër, kurse 1 nuk ka votuar.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- pika 2.3 u hoq nga rendi i punës, prandaj ju lus që të deklaroheni se kush është për këtë rend të punës duke e shtuar një pikë tjetër: Plani i punës dhe orari i takimeve të KK-së?

Sahit Abazi- nëse nuk ka disponim politikë për ta trajtuar temën e Sergjanit, ne kërkojmë një pushim të shkurtër dhe pas atij pushimi dalim me qëndrimet tona.

Lutfi Haziri- të nderuar anëtarë të Kuvendit dhe ju pjesëmarrës në këtë seancë të fundit të këtij viti i cili vit ka qenë i rëndësishëm, i suksesshëm me sfida dhe me telashe të veta dhe është përcjell me interesim nga qytetarët. Temat të cilat e kanë përcjell këtë Kuvend që nga janari deri në dhjetor kanë qenë të njëjta, retorika e njëjtë politike, insinuata, kualifikime që bazohen apo motivohen në prapavijë politike.

Unë jam i zgjedhur si kryetar drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe llogarinë e kam me qytetarët të cilën bazoj dhe mbaj, kurse raportin me Kuvend e kam të rregulluar me ligj. Edhe anëtarët e Kuvendit i kanë të rregulluar me ligj raportet e tyre dhe duhet t' i përmbahen atij raporti.

E dyta nuk merrem me fosile politike dhe mbetjejet e Serbisë në Kosovë si pasojë e mosrealizimit në tërësi të të gjitha mekanizmave, falangave edhe atyre pjesëve të ndryshkura të Serbisë pas 10 qershorit të vitit 1999 është çështje që duhet ta vlerësojnë organet e shtetit dhe jo kuvendet komunale.

Kolegu u juaj është zgjedhur nga lista e iniciativës qytetare, sipas ligjeve të Kosovës dhe ka fituar votën qytetare.

Bashkë partiaku i tij ka qenë zv/kryetar i Komunës për 4 vjet në Komunë të Gjilanit dhe ka punuar me ligje të Kosovës.

Ky anëtar i Kuvendit është sot këtu duke e përfaqësuar një pjesë të komunitetit pakicë në një listë politike e cila është e përfaqësuar dhe është e ndarë Lista serbe për Kosovën, por nëse është bashkuar më vonë apo ka bërë marrëveshje politike, kjo është çështje e tij. Kjo sa i përket ulëses së tij në Kuvend, kurse sa i përket emërimit të tij për mua është e papranueshme e patolerueshme dhe çdo lloj ndërhyrje e sistemit juridik të Serbisë brenda territorit të Kosovës dhe brenda territorit të Komunës sonë. Është e patolerueshme dhe papranueshme dhe do të kundërshtohet deri në fund dhe do të paralizohet dhe paaftësohet roli tyre në jetën institucionale të Kosovës. Mirëpo iu lus që mos të merreni me diçka që nuk është autoritet përgjegjësi dhe kërkesë. Nënkrjetari i cili do të emërohet dhe që pritët të emërohet do të vijë nga komuniteti pakicë në Gjilan dhe do të punojë me ligje të Kosovës, ashtu siç do të punohet në emërimin e të gjithë drejtorëve të shkollave e që është shpallur konkursi dhe autoriteteve tjera në bazë të LVL-së.

Një anëtarë i Kuvendit që nuk e dinë që Qeveria e Austrisë ka nënshkruar Marrëveshje me Qeverinë e Kosovës dhe ratifikimi i marrëveshjes është ligj dhe sipas këtij ligji Gjilani ka konkurruar për t' i marrë 12 milion € nga kjo e drejtë.

Ne jemi njëra prej 10 komunave që kemi konkurruar dhe njëra prej dy komunave që jemi përzgjedh për të përfituar.

Detajet e kontratës do të negociohen në janar 2016 në mes ministrit të Financave të Kosovës dhe atij të Austrisë, kurse dëshmitarë në proces do të jemi ne të kontratës si Komunë përfituese. Nuk është OJQ, as nuk është bankë, por mjet të Qeverisë së Austrisë që i ndajnë nga buxheti i tyre për investime jashtë vendit të tyre. Ne kemi konkurruar dhe nuk është dhuratë dhe kemi përfituar për trajtim të ujërave të zeza, rregullimin e Shtratit të Lumit Stanishorka, pjesërisht Mirushësn dhe integritet të sistemit të kanalizimit për 54 km në territorin e Komunës së Gjilanit.

Sa i përket kontratave tjera, marrëveshjeve tjera me USAID-in me Qeverinë Amerikane, atë Gjermane dhe Zvicerane dhe qeveritë e tjera ne i kemi të nënshkruar dhe ato janë donacione dhe janë grand për Komunën e Gjilanit. Pjesëmarrja e jonë është simbolike dhe ne me këto qeveri kemi projekte të zgjedhura.. Me Qeverinë Amerikane e kemi çerdhen për fëmijë, me atë Gjermane mbështetjen e korrikulës së arsimtarëve dhe efijencën e energjisë elektrike, renovimin e disa shkollave dhe objekteve. Me Qeverinë Zvicerane e kemi rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit për të gjitha fshatrat dhe pjesët rurale të Komunës së Gjilanit.

Sa i përket buxhetit përderisa marrëveshja e Berzh-it e nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës në masën 70% mjetet janë për Gjilan, vetë gjilanasit këtë e kundërshtojnë në vend që ta duartrokas in marrjen e këtyre projekteve për Gjilanin.

Projekte të mëdha për Gjilanin janë dy korridore Gjilan –Ferizaj dhe Gjilan- Prishtinë. Këto janë hyrje dhe dalje të qyteti dhe janë mjete që janë nënshkruar dhe janë në procedurë, kurse vitin e ardhshëm do të realizohen. Këto janë projekte të mëdha dhe ky projekt është i përfunduar njëherë për njëherë vetëm deri në Pasjak. Ne kemi projektuar hyrje dhe dalje për Ferizaj, por kjo rrugë do të shkojë deri në Kllokot. Po ashtu edhe çështja e autostradës është ndikuar jashtëzakonisht shumë prej Gjilanit. A frikohem unë prej rivalëve se kush e ushtron detyrën, z. Nevzadi shumë gabim e ke ? Unë nuk jam frikuar për të konkurruar asnjëherë dhe deri m tash ju e dini rezultat in zgjedhor, por aq më pak jam frikuar prej falangave që ma zënë vendin. Jam jashtëzakonisht krenar përkundër modestisë sime dhe po iu them se unë i përfaqësoj me 60% me votë të qytetarëve, kurse ditën e betimit 100% me votë të qytetarëve të Gjilanit. Mirëpo nëse vazhdon të ndahet ajo hisja e z. Nevzadi ajo pjesë e votimit tuaj është 13%. Askush nuk duhet t' i jap peshë vetes më shumë se ka besim tek qytetarët e vetë. Nëse dëshirojmë për inate politike për të njollos, ne vazhdomë të luajmë, por kam treguar në fillim të mandatit se në lojën e pështymës nuk marrë pjesë. Pas dy vjet po e përsëris edhe njëherë se nuk marrë pjesë në gara të tilla dhe nëse e dëshironi këtë lojë, gjeni tjetër konkurrent e që po mundoheni ta gjeni një i cli është shumë i interesuar të marrë pesë në garën e pështymës. Sa i përket punës, vlerave, kontratave të uljes së shpenzimeve një botë e ka marrë vesh këtë punë që ne jemi shpallur Komuna me shpenzime më të ulëta në Republikë. Ne jemi Komuna shembull e disiplinës buxhetore, tendenca për të gjet diçka për të thënë që u

bë nuk mund të mbulohet ai ushqim që i keni harxhuar 160 mijë € në vit. Ato gjëra kanë kaluar, por kjo është mësim dhe ndoshta ne do ta kishim bërë atë gabim, por kemi marrë mësim nga dikush dhe nuk e përsërisim. Gjithmonë ne nxjerrim mësim prej gabimeve të tjerëve. Këtë vit i kemi dhënë 140 mijë € për sport, vitin e ardhshëm 210 mijë €, kemi dhënë për kulturë dhe e kemi rrit në 213 mijë €. Ne kemi ndarë mjete për OJQ dhe në veçanti për infrastrukturë. Do të jeni dëshmitar vitin e ardhshëm se sa është buxheti, sepse nuk po lexohet drejtë buxheti nga disa individ. Do të bindeni se sa do të punojmë vitin e ardhshëm dhe sa punë do të fillojnë.

Është fundi i vitit unë iu uro të gjitha të mirat edhe juve dhe çdo qytetari duke shpresuar se viti i ardhshëm do të jetë më i mirë se ky.

Selami Xhemajli- unë kërkoj 15 minuta pushim për ta bërë një bisedë me shefat e grupeve përkitazi me situatën që u krijua me kolegun tonë.

Valentinë Bunjaku -Rexhepi – edhe z. Abazi kërkoi pushim, prandaj kryesuesja i propozoi 20 minuta pushim dhe pas pushimit seanca do t' i vazhdoi punimet.

Riad Rashiti- nuk keni guxim për të u përball me replikë, zonja kryesuese dhe nuk mund t' i ikni debatit, kryetari duhet ta ketë guximin për debat dhe jo për të shpif, manipuluar dhe paraqit shifra të rrejshme.

Pas pushimit prej 20 minutave, seanca i filloi punimet

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- pozita dhe opozita kërkojnë që z. Sergjani ta lirojë sallën, sepse nuk ka disponim të jetë në sallë nëse nuk deklarohet se është vetëm anëtar i KK-së duke i respektuar ligjet e Republikës së Kosovës.

Sergjan Mitroviç- kërkesa e kryesueses nuk është në pajtim me ligjin, sepse unë këtu jam i zgjedhur nga populli dhe populli më ka zgjedhur në pozitën e anëtarit të Kuvendit, prandaj nuk e marr parasysh kërkesën e juaj.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- ju jeni zgjedhur nga vota e popullit, por e keni keqpërdor besimin e qytetarëve, prandaj kërkojmë që ta dilni nga salla e KK-së. Kërkoj që Sergjan ta lirojë sallën, sepse me këto sjellje nuk e pranojmë prezencën e tij këtu në Kuvend.

Arben Mehmeti- së pari atë që po e planifikojnë grupet politike për ta zbatuar është i vonshëm, sepse veprimi i anëtarit të Kuvendit (Segjanit) e ka cenuar rëndë legjislacionin e Republikës së Kosovës me vetë faktin se e ka zyrtarizuar pjesëmarrjen në organizatat paralele e të cilat funksionojnë në kundërshtim me ligjet e Republikës së Kosovës. Edhe e dyta na ka provokuar jashtëzakonisht rëndë si institucion më i lartë i Komunës së Gjilanit. Në këso rrethana këtij personi nuk iu është deshtë t' i lejohet të vijë në seancë të KK-së fare. Le të ankohet anëtari komunal dhe mos të ankohemi ne si Kuvend, por ai të ankohet për atë që nuk i lejohet pjesëmarrja në KK për arsyeje se veprimet e tij i kanë cenuar ligjet në Kosovë. Për derisa nuk sqarohet se a ka të drejtë pjesëmarrje apo nuk ka ky anëtar i Kuvendit duhet të mbesë jashtë sistemit të funksionimit të KK të Gjilanit. N këtë rast ai le t' i bëjë ankesat përmes institucioneve të Republikës së Kosovës. Nëse Zyra e MPL-së konstaton se veprimi i tij është në harmoni me ligjet e Kosovës, atëherë ne punojmë ashtu siç kemi punuar deri më tash. Unë kërkoj pauzë 5 minuta për një bisedë të shkurtër dhe për t' u marrë vesh që mos ta lejojmë pjesëmarrjen e tij në Kuvend.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- unë pajtohem me z. Mehmeti dhe ne do t' i drejtohem me shkrim institucioneve tona dhe do të kërkojmë përgjigje. Mirëpo edhe njëherë e lus z. Segjanin që ta lirojë sallën,

por nëse nuk e liron atëherë do t' i marrim 10 minuta pushim dhe do t' i marrim masat e duhura dhe do të vendosim se si do të vazhdojmë në vijim.

Edhe pas kësaj fjale të kryesuese z. Segjani nuk bëri asnjë komet, kurse kryesuesja i liroi në një pushim 10 minuta anëtarët e Kuvendit.

Pas 10 minutave seanca i filloi punimet, pas së cilit pushim z. Mitroviç doli nga salla e KK-së.

Në pjesën e 3 të seancës ishin të pranishëm 34 anëtarë të Kuvendit.

Lidhur me largimin e z. Mitroviç znj. Kryesuese e lexoi rregulloren në bazë së cilës z. Mitroviç është larguar nga salla.

Aprovohet kërkesa e kryesueses që z. Mitroviç të largohet nga salla me 29 për, kurse 3 anëtarë munguan.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- pika 2.3 u hoq nga rendi i punës, prandaj ju lus që të deklaroheni se kush është për këtë rend të punës duke e shtuar një pikë tjetër: Plani i punës dhe orari i takimeve të KK-së?

Aprovohet ky rend i punës me 24 vota për, kurse 4 nuk votuan, 1 ishte abstenim

Bujar Nevzadi- të falënderoj për qëndrimin që e pate përkitazi me anëtarin e Kuvendit, por e kam një reagim ndaj kryetarit të Komunës për fjalën që e pat dhe e kam ditur që ai më nuk do të vijë më në Kuvend, sepse kështu e kemi një kryetar. Unë personalisht, ia përmendi votat, unë nuk kam aq vota sa ka ai, por kam fytyrë. Unë mund të ballafaqohem me çdo qytetarë të Gjilanit, kurse kryetari jonë kështu ka ardhur kryetar dhe kështu ka punuar tërë jetën.

Ju e pat se doli e akuzoi këtu pa asnjë argument dhe iku. Unë e pyeta për skandalin e fundit të vizitës në Kanadë, ai doli krejt në tjera gjëra. E pyetëm për tenderët dhe çështje konkrete ai u soll rrethe rrotull pa dhënë asnjë përgjigje. Unë po e pres seancën tjetër për t' i thënë kryetarit ballë përballë, sepse nuk kam folur kurrë pa argumente.

Më vjen shumë keq që e kemi një kryetar të tillë shakaxhi dhe mashtrues për fat të keq, por kështu kanë vendosur qytetarët e Gjilanit. Unë me 500-600 vota sa i kam, kam edhe fytyrë.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- ju lus dhe kërkoj që ta përdorni një gjuhë më parlamentare në Kuvend, sepse jemi njerëz dhe atë që duam ta themi mund ta themi me gjuhë parlamentare, por edhe ekziston edhe rregullorja e punës së Kuvendit.

Riad Rashiti- mua më vjen keq që kryetari po i ik debatit me argumente dhe me fakte qoftë me opozitën qoftë me ndonjë institucion tjetër. Unë i parashtrova 5 pyetje asnjë përgjigje nuk e mora (një gjithsej). Nuk u përgjigj për prokurimin, nuk u përgjigj për dallaveret në tender, nuk u përgjigj për uzurpimet dhe nuk u përgjigj për ndërtimet e egra pa leje dhe nuk u përgjigj për asnjë çështje. Kryetari gjithmonë i ik përgjigjeve dhe nuk përgjigjet edhe pyetjeve me shkrim dhe kaluan dy vite në asnjë kërkesë nuk na është përgjigj. Sot i iku debatit dhe kjo nuk është as e ndershme as e moralshme dhe as politike.

Cila është arsyeja pse nuk është zgjedhur nënkryetari nga komuniteti serb që dy vite, cila është arsyeja? Nuk ka përgjigje? E përmendi ratifikimin e Marrëveshjes me Austrinë për të investuar për projekte madhore në Gjilan, por unë sot e lexova një portal në "Koha net" një portal që paraqet Marrëveshjen që e ka nënshkruar ministri i Financave për projektet milionëshe që vijnë, por ato nuk kanë të bëjnë asnjë € me Komunën e Gjilanit, por janë për komunat e tjera.

Ju po flitni për shifra në qiell të pabazuara askund. Ju investimet i keni të projektuara të nënshkruara, por ju nuk i lejoni që të ndodhin ato!? Kryetari e përmendi rrjetin e ujësjellësit për të cilin rrjet ka investuar

Qeveria Zvicerane dhe e tha se është meritë e tij, por ai po harron që këto projekte Qeveria e Zvicrës i ka përkrah që nga pas lufta. Asnjë meritë ky kryetar i Komunës nuk e ka pasur për këtë donacion.

Kryetari e tha se shumë pështymje po bëjmë këtu në Kuvend. Mirëpo a ka pështymje më të madhe se sa qytetarët e Gjilanit pështyen që dy vite, me anashkalim të buxhetit, me dallavere të tenderëve dhe me shpenzime enorme e që neve po na akuzoni se i kemi shpenzuar 160 mijë € mish. Nuk është e vërtetë, keni deklaruar se i kemi lënë 9 milion € borxhe dhe në fund nuk dolën as 2.5. Çdo gjë ka qenë manipulim dhe mashtrim me deklarata të papërgjegjshme.

Nëse janë shpenzuar këto 160 mijë €, siç po thoni ju, janë shumë të vogla se ju që i keni shpenzuar 1 milion € për shërbime e të cilat i përmenda më herët. Për katër projekte keni 1 milion € rritje të shpenzimeve.

Nëse ne kemi bërë shpenzime ne i kemi bërë letra, kure ju po i bëni pa letra, ju hani dhe pini tërë ditën dhe natën, kurse faturat ia paguajnë bizneset e të cilët i korruptojnë zyrtarët e Komunës. Si mund të arsyetohet 400 mijë € tender më i madh se i vitit të kaluar. Nuk e di si mund të arsyetohet kjo, nuk kemi përgjigje nga asnjë zyrtar dhe udhëheqës.

Po flitni për dietë buxhetore, nuk ka dietë buxhetore, por ka shpenzim enormë, por të gjitha këto i mbulojnë bizneset

Ndodhin kontrata me kuotim 10 mijë €? A dini sa kontrata janë nënshkruar dhe dallavere janë bërë gjatë këtij viti dhe vitin e kaluar? Nuk është mirë të vijë kryetari të na tregojë se kush po pështynë, sepse ai po pështynë dhe nuk ka kontroll absolutisht as në buxhet as në prokurim as në ndërtimet pa leje as në urbanizëm dhe në asnjë punë nuk ka kontroll.

Projektet që i përmendi mund t' i lexoni në portale dhe milionët që vijnë në Kosovë nuk kanë të bëjnë asnjë € me Komunën e Gjilanit. Po flitet me shifra në qiell, por të pabazuara në asnjë dokument.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

2.1- Kërkesë për ndryshimin e projektit për rregullimin e shtratit të Lumit Mirusha

Rexhep Kadriu- lidhur me nevojën e ndryshimit të projektit të Lumit Mirusha, arsyetimin e dha zv/kryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu i cili dhe sqarime të hollësishme me anë të projektorëve, duke kërkuar që të aprovohet ky ndryshim i projektit.

Avdyl Aliu- në emër të grupit të LDK-së, unë po e shpreh kënaqësinë për faktin se punëve të mira veç po iu vjen radha, sepse së bashku në këtë sallë po e marrim një vendim të mirë siç rasti edhe për ndryshimin e shtratit të Lumit Mirusha.

Në mbledhje të fundit të KPF-së e vendosëm për ta rekomanduar për Kuvend një zgjidhje të mirë për këtë lumë dhe do të kishte qenë mirë që kjo zgjidhje të ishte bërë edhe më herët, por tash na ka ardhur radha dhe më mirë vonë se kurrë.

Komuna nuk është institucion për punësime, por ajo duhet të krijojë mundësi për punësime dhe duhet të krijojë edhe klimë të mirë dhe të favorshme për investitorët dhe politika investuese që hapin vende të punës.

Ky projekt e ka këtë karakter dhe qëllimi i çdo projekti është qëndrueshmëria e tij dhe gjenerimi i vendeve të punës.

Me këtë projekt rregullohet ambienti, përfitojnë qytetarët, humbet mundësia për degradim të qytetit dhe nuk ka mundësi më të hedhen mbeturina dhe bëhet një lëvizje e lirë dhe e qetë e qytetarëve. Largohet mundësia për deponi ilegale, krijohet mundësia për investime për gjatë të gjatësisë së këtij lumi, rritet vlera e pasurisë ekzistuese etj.

Shpresoj se përfundimi sa më i shpejtë i këtij segmenti do ta na jep arsien për të menduar edhe për pjesën e epërme dhe të poshtme të këtij segmenti, prandaj iu ftoj për të votuar për këtë ndryshim të projektit.

Nevzad Rushiti- edhe unë po i shtoi disa fjalë edhe pse mjaft mirë u elaborua ky projekt nga zv/kryetari , por kësaj çështje i kam kontribuar edhe në KPF duke e arsyetuar se disa koleg që janë këtu edhe në mandatin e kaluar kemi dhënë vërejtje që po të kishte pasur lumi ujë, normal që do të ishim për të qenë i hapur, por fatkeqësisht ne nuk mund të sjellim ujë në mënyrë artificiale ashtu siç u tha nga disa kolegë në seancën e kaluar.

Ashtu siç është gjendja faktike unë mendoj se ky projekt dhe ndryshimi i këtij projekti duhet të aprovohet, sepse si shembull i mirë dhe i këtillë është Lumi Banja (i mbyllur) për të cilin projekt qytetarët janë shumë të kënaqur. Edhe Lumi Banja është i mbyllur, por ka dhënë rezultate të mira, prandaj mendimi i im është që ky projekt në të ardhmen të vazhdojë i mbyllur nga rruga e Dardanisë deri në rrugën e Prishtinës, sepse atje kanë filluar ndërtimet e larta dhe mendoj se në këtë mënyrë ky projekt do të jetë më i mirë.

Arben Maliqi- shefi i grupit e tha atë që duhet të thuhet, por pasi unë i takoj asaj lagjeje do ta jap kontributin tim, sepse edhe kam qenë në proces dhe rrjedha të projektit të këtij lumi i cili ka filluar që nga viti 2002. Tash e kemi një riprojektim dhe unë do t' i jap disa arsyeje pse është mirë të ndodh kjo ? Një qytet i cili nuk ka lumë është qytet me më pak vlera dhe nuk mund të quhet qytet, prandaj Gjilani nuk e ka një lumë, por është një përroshkë e cila më shumë ka ujëra të zeza(kanalizime). Solucioni më mirë do të ishte të jetë i hapur, mirëpo kjo është e pamundur, sepse së pari nuk ujë të mjaftueshëm, nuk ka rrjedhe të lumit dhe mirëmbajta e tij dhe kujdesi do të ishte i pamundur, sepse ajo është një kulturë e veçantë. Pse duhet të jetë i mbyllur ? Së pari duhet të jetë i mbyllur për t' u larguar kundërmimi, sepse në të dy anët hidhen mbeturina dhe mund të del uji jashtë shtratit. Kjo nga ndodhur nga qytetarët e paarsyeshëm dhe kanë gjuajtur mbeturina, material të ngurtë, por nëse mbyllet lumi kjo nuk do të ndodh. Një përparësi tjetër është se të gjithë qytetarët të cilat i kanë shtëpitë afër do të jetë edhe një mundësi për hapjen e dyqaneve zyrtare dhe artizanaleve të ndryshme. Do të jetë një shëtitore prej Hotelit "Kristal" deri te Çezma e Balcit , por ajo çka është më e mira është që nga Xhamia deri te Kompleksi i shkollave të mesme kemi një frekuencë jashtëzakonisht të madhe të qytetarëve dhe nxënësve tanë. Me këtë rast do të bëhet shkarkimi, sepse shumë qytetarë do të qarkullojnë rrugës më të shkurtër. Edhe njëherë po e them se mundësia është shumë e vogël për të qenë një lumë i hapur, mirëpo mendoj se deri te Çezma e Balcit është një zgjidhje e duhur për momentin.

Selami Xhemajli – ne si grup i anëtarëve të Kuvendit nga AAK e kemi shqyrtuar, kërkesën të cilin në mënyrë profesionale e prezantoi zv/kryetari i Komunës, për çështje të ndryshimit të projektit të Lumit Mirusha dhe të gjitha ato arsyeje duke i shtuar edhe ato të kolegëve, unë i jap mbështetje këtyre ndryshimeve në këtë projekt dhe e përkrahim.

Riad Rashiti- në emër të grupit PDK-së po i jap vlerësimet tona, sepse e kemi analizuar me kujdes këtë propozim që ka ardhur për ndryshim. Ne kemi konstatuar se këto ndryshime që por propozohen janë në kundërshtim të plotë me ligjin e Republikës së Kosovës, por edhe bazuar në direktivat e BE-së, e të cilat janë pjesë e aneksit të ligjit ku saktësojnë shumë saktë mundësitë e ndërhyrjes në lumenjtë dhe në shtretërit të lumenjve. Sipas nesh kjo është kompetencë e Ministrisë dhe Planit nacional 2010-2020.

Për këtë arsyeje ne si PDK e kundërshtojmë zëshëm këtë ndërhyrje jo ligjore që po e bën Komuna e Gjilanit. Ky propozim i sotëm u tha se është analizuar dhe propozuar, por ne nuk e dimë se cili projektues e paska bërë ndryshimet? Unë si anëtar i Kuvendit e kam marrë obligim për të kontaktuar me projektuesin e këtij projekti dhe sipas tij, ai absolutisht nuk ka punuar në këtë drejtim për të bërë ndryshime të tilla në këtë projekt.

Nuk është respektuar procedura, nuk është respektuar projektuesi, është konflikt ligjor, sepse është kontrata e nënshkruar me një projektues dhe është nënshkruar kontrata me një operator e cila është duke i kryer punët, prandaj për neve ky ndryshim është jo ligjor. U tha nga nënkryetari se kemi qenë të

detyruar? Cili detyrim ka qenë? I individëve për përfitime të biznesit, keni qenë të detyruar nga biznesi i ndërtimeve të larta që u përmend këtu, apo cilat janë arsytet?

Nëse është kërkesë e 260 qytetarëve, nuk e kam të qartë se sa do të jetë numri që nga fillimi deri në mbarim? Ato nënshkrime keni qenë të obliguar të na i dërgoni edhe neve të skanuar si peticion me adresë elektronike dhe për të na e sjell komplet materialin. Ju nuk keni sjell asgjë dhe vetëm e bëtë një prezantim dhe disa fotoshoppingje.

Në të kaluarën disa asamblast në të kaluarën e kundërshtonin mbulimin e shtratit, kure tash japin mendimin për ta mbuluar lumin. Për neve si PDK dhe opozitë nuk ka asnjë arsyeje tjetër përpos përfitimeve të disa bizneseve aktuale që janë bërë të fuqishme në këtë qeverisje, sepse do të nevojiten me mijëra tonelata beton për ta mbuluar këtë lumë. Është mirë të na e prezantojë zv/kryetari sa tonelata beton nevojiten për mbulim të këtij lumi.

Unë mendoj se pas kaosit urbanistik dhe pas ndërtimeve pa leje dhe pas buxhetit i cili po shpenzohet në mënyrë të pakontrolluar, kjo është katastrofa e tretë që po i ndodh në këtë qeverisje Gjilanit. Të gjitha arsytet të cilat i tha zv/kryetari asnjëra nuk qëndrojnë, prandaj edhe njëherë po theksojmë se ka qenë mirë për të na i dhënë bazën juridike në bazë të cilit ligj në bazë të cilës drejtë na ka ardhur ky propozim ndryshim në Kuvend. Në bazë të ligjit 04L/147 për ujërat e Kosovës kjo iu ndalohe, sepse thuhet saktë se kur Komuna ka të drejtë dhe nuk ka të drejtë Komuna të ndërhyjë në devijimin e shtratit apo ndërtimin e objekteve të larta në këtë projekt.

Si pyetje tjetër është se kur e keni ndërmend ta përfundoni këtë projekt, sepse që dy vjet e keni marrë pushtetin, kurse ka mbetur ky projekt në atë vend dhe nuk ka lëvizur asnjë metër?

Nevzad Isufi- është e vërtetë se në KPF e kemi debatuar këtë çështje dhe e kemi rekomanduar për Kuvend, por kemi kërkuar që materiali të jetë më voluminoz dhe të ketë më shumë informacione, por materiali na ka ardhur i kompletuar, por ka ardhur i njëjti dhe këtu thuhet të nderuar anëtarë të KPF-së e që do të thotë se nuk është menduar që t' i ofrohet anëtarëve të Kuvendit si material shtesë. Materiali i dërguar është më tepër material i cili mund t' i dërgohet profesionistëve të caktuar (arkitektëve), por ne nuk mund të jemi të gjithë arkitekt këtu. Atë arsytet që e dha nënkryetari këtu gojarisht ka mund të jetë edhe në formë të shkruar, sepse është fjala për një projektet shumë madhore, por i cili po duket i përealizueshëm për 14-15 vjet. Vërejtjet janë edhe në pikëpamje transparente, sepse u përmend edhe peticioni i qytetarëve, por ne si opozitë nuk kemi qenë në dijeni për këtë peticion, prandaj shtrohet pyetja se çka do të ndodh nëse dalin po aq qytetarë kundër këtij ndryshimi (shtrati i lumit të mbetet i hapur siç ka qenë projekti i parë)?

Gjithashtu nuk u dhanë arsytet se cilat janë përfitimet e tjera në raport me projektin e mëparshëm, qoftë edhe në pikëpamje financiare, sa kursehet në variantin e parë dhe sa në të dytin. Gjithashtu po duket se po ikim tendencës për punësim, por në anën tjetër edhe uzurpimeve që janë bërë skaj shtratit të lumit, sepse ndërkohë paskan ndodhur ndryshime, por në të njëjren kohë është dashur të na sqarohet se çka ka ndodhur me këto ndryshime dhe për cilat ndryshime bëhet fjalë?

Në këtë formë duket se nuk jemi shumë transparent, sepse ne i kemi tri -katër faqe material dhe ato të fotokopjuara tejet dobët dhe nuk ishin ashtu bukur siç i pamë në projektor në sallë. Nëse projektuesi i parë nuk ka thënë se është projekt i imi pjesa e dytë, atëherë shtrohet pyetja kush është projektuesi real? Gjithashtu për qytetarët është bërë aq e mërzitshme ajo punë sa që ata janë në gjendje të pajtohen edhe me një kompromis edhe më të pafavorshëm vetëm që të hiqet ai kundërmim i rëndë i cili është i padurueshëm edhe për një kalimtar, kurse për ata që e bëjnë jetën aty afër është tejet gjendje më e rëndë. Për mua ky projekt do të ishte më mirë të përfundojë qoftë i mbuluar qoftë i hapur sa më shpejtë, sepse kjo është bërë e tepërt për qytetarët të cilët po jetojnë në një ambient të tillë. Do të duhej një elaborim më i mirë në rastin kur lumi është i mbuluar dhe cilat përfitimet në rastin kur është i hapur? Mos të harrohet se nuk është e pamundur ideja se mund të sillen ujë edhe nga shpimet dhe vërtetë Gjilani të jetë qytet me lumë. Ne jemi për çfarëdo zgjidhje që i konvenon qytetarëve, por duke menduar në rolin e qytetarëve që jetojnë aty ishte dashur të shikohet interesi i përgjithshëm, por mundësisht brenda interesit të

përgjegjshëm edhe interesa të veçanta, por jo për t' i ik lëshimit të pronave publike, përfituesve privat dhe ndryshimit të planit për shkak të presionit për përfitime personale dhe materiale.

Jakup Bajrami- unë fillimisht i kam disa pyetje sa për t' u bindur se duhet ky projekt të zbatohet në këtë variantin që sot po prezantohet. Nuk ka nevojë të debatohet se kur ka filluar ky projekt dhe kur do të përfundojë, por dihet se është një histori mjaft e gjatë. Në kohën kur është bërë ky projekt neve na është thënë se lumi patjetër duhet të jetë i hapur për shkak se nuk guxojnë të mbyllen lumenjtë. Nëse ka qenë atëherë lumë, atëherë edhe sot duhet të jetë lumë, nëse atëherë nuk ka pasur ujë edhe sot nuk ka ujë. Unë mendoj se kjo procedurë ka qenë deshtë të shtrohet si pyetje në këtë Kuvend.

Kërkesë nëse është edhe e qytetarëve dhe të bëhet një vendim për ta reviduar këtë projekt nëse duhet të bëhen ndryshime të domosdoshme. Mendoj se këto procedura janë bërë pa argumente dhe pa plan dhe pa argumente të duhura.

Unë në grupin e anëtarëve të KK-së kam bërë pyetje i kam dhënë këto vërejte dhe këto po i jap edhe sot. Nëse është e nevojshme për ta bërë një ndryshim ne po e bëjmë, por ku po na dërgojnë këto ndryshime të projekteve të cilat po dështojnë e jo vetëm ky, por edhe projektet e tjera e që janë bërë në mënyrë jo profesionale, pastaj po paraqitet nevoja për ndryshim. Duhet pasur kujdes se projektet të cilat aprovohen të bëhen ashtu si duhet, sepse në këtë mënyrë neve po na bëhen edhe shpenzime pa nevojë. Unë jam i mendimit që ndoshta është më mirë për ta shtyrë këtë propozim të sotëm derisa të bindemi se duhet bërë këso ndryshime.

Ismet Hajdini- fjala më shpeshtë e këtij Kuvendi është: “interesi i qytetarit” ... Sa i përket këtij projekti, unë kam lind dhe jam rritur dhe po plakem afër këtij lumi dhe realisht të gjithë ata që jetojnë afër Mirushës janë për mbulimi e Mirushës, sepse Mirusha nuk është lumë, por është përroskë. Mirëpo disa individ që janë me kilometra larg kësaj përroske flasin për hapje, por po të kishin qenë edhe ata pjesë afër Mirushës edhe ata kishin deklaruar se duhet të mbyllet.

Mua po më habitin disa anëtarë të Kuvendit, sepse tepër po merren me paragjykitime se gjoja dikush do të përfitojë dhe është interesi i dikujt, mirëpo nëse ka dikush tokë aty me dekada të tëra pse mos të përfitojë?

Unë edhe në qeverisjen e kaluar kam qenë anëtarë i Komisionit së bashku me Riadin dhe mbi 90% të qytetarëve janë deklaruar për mbyllje të Mirushës. Mirëpo më vije keq, sepse ky projekt ka qenë dashtë të vazhdojë deri te Shtëpia e Shëndetit dhe nuk e di pse është ndal deri te Çezma e Balecit, sepse ishte bërë një lidhje shumë e mirë me QMF-në.

Fehmi Sylejmani- duhet ta them se Mirusha është bërë “përrallë, Mirusha legjendare” dhe më së paku qytetarët e Gjilanit e kanë merituar. Këtu për pa dashe për të akuzuar ose lavdëruar edhe qeverisja e kaluar i ka fituar votat duke propaganduar për këtë lumë, por prapë edhe pushteti aktual ka filluar dhe po vazhdon me të njëjtën. Pasi që tash po bëhet një propozim dhe propozohet një ndryshim, na shtrohen shumë pyetje tash. E par pyetje që është se këta qytetarë që janë afër këtij lumi nuk e kanë merituar këtë tretman deri më tash?

Pyetja e dytë është: “kostoja e këtij ndryshimi a do të jetë më e lirë apo më e shtrenjtë, se sa projekti i parë që ka qenë i planifikuar si i hapur?”

Pyetje tjetër e cila u ngrit dhe u përmend se nuk është shumë e arsyeshme dhe njerëzore nëse e bëjmë parçialisht ndarjen ose mbulimin, sepse në këtë mënyrë bëhet një padrejtësi? Po ashtu ky projekt tash nuk është i kësaj qeverisje, sepse ky projekt ka qenë i kohës së komunizmit, sepse si fëmijë e di që është thënë se në një kohë do të jetë si shëtitore dhe me ndriçim, por deri më sot nuk është realizuar kjo ide. Mirëpo këtu u tha se po devijohet projekti i cili fakt për mua len shumë dilema të cilat patjetër duhet të eliminohen. Nëse ka filluar ky devijim atëherë unë do të kisha thënë pak më ironike është mirë që të shtrohet një bazë e mirë e betonit, sepse shumë lehtë mund të ndërtohet një objekt mbi atë lumë, ashtu si

po ndërtohen ndërtimet e larta. Ka shumë mundësi që edhe aty të fillojnë ndërtesat të lulëzojnë, sepse nuk është i palogjikshëm edhe ky rast.

Bajram Hasani-unë deshta për ta ngrit si çështje edhe Komitetin e Urbanizmit i cili pas shkuarjes së Murat Hoxha në pozitën e deputetit të Kuvendit të Kosovës dhe i cili ka qenë kryesues, tash e tutje ky komitet nuk është duke funksionuar dhe jam i bindur që kjo çështje e lumit ka qenë deshtë të kalojë përmes Komitetit të Urbanizmit.

Unë jam për mbyllje dhe jo që nuk i besoj profesionalizmit të zv/kryetarit, por ka qenë deshtë të bëhet edhe një konsultim me urbanizmin. Kërkoj që të jetë një kontakt edhe me urbanizmin ose Sektorin e Planifikimit, sepse tash po paraqitet një trajtim tjetër.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- Komiteti është shumë funksional dhe gjithçka është në rregull, sepse është rekomanduar për KPF dhe mandej në Kuvend.

Rexhep Kadriu- unë po i përgjigjem, grupit të PDK-së e të cilët po thirren në ligj, kur dihet dhe e prezantova në projektor dhe realisht PDK-ja e ka shkel ligjin. Segmenti “B” nga Hoteli “Kristal” deri te tregu e keni mbuluar pa procedurë.

Asnjë procedurë nuk e keni respektuar dhe as në Kuvend nuk e keni miratuar dhe nuk është ndonjë vendim i nxjerr për ndryshim. E keni kryer kokë në vete, por ky është problem tjetër dhe ka kush merret me ato tema.

Sa i përket konsultave jam i informuar se e keni thirr projektuesin Ilir Gjinollin, por edhe ai ka thirr dhe është interesuar dhe ka kërkuar ta dijë se a është ndërhyrë në projekt (zv/kryetari e paraqet një dokument) me të cilin dëshmohet se këto ndryshime i ka bërë vetë Ilir Gjinolli. Sa harxhohet beton është një pyetje? Prapë duhet ta pyesim Riadin se sa ka harxhuar beton nga Kristali e tutje? Sa i përket përfundimit iu garantoj se projekti do të përfundojë në vitin 2017.

Kush e ka ndal që mos të përfundojnë punët, prapë edhe këtë po e sqaroj!

Me aprovimin e buxhetit të Republikës së Kosovës në vitin 2014, ka qeverisur partia e PDK-së dhe kjo parti 150 mijë € buxhet për këtë lumë dhe kur keni ikur nga pushteti në fund të vitit 2013 i keni lënë borxh 300 mijë €.

Duhet t’i tregosh qytetarëve? Mirëpo me 150 mijë € ne nuk kemi mund të punojmë me ato mjete që i ka lënë Hashim Thaçi, por kur t’i sigurojmë parat ne në fund të vitit 2017 do ta përfundojmë këtë projekt. Pyetje pat për koston? Kostoja do të jetë 1 mijë e 100 € për metër gjatësi të mbulimit të lumit dhe ndryshime nuk do të ketë, përpos dizajnit në fund i cili prapë do të vendoset se në cilin dizajn do të shkojmë. Sa i përket segmenteve ne do ta punojmë segmentin e parë “B” dhe për ta parë të gjithë qytetarët se çfarë projekti është?

Z. Jakup Bajrami e tha se para disa vite ka qenë e paraparë që ky lumë të jetë i hapur (i zbuluar), por para disa vite ka pasur të reshura më tepër, por sipas disa parashikimeve që ka bërë GIZ-i e të cilat i posedojmë ne të reshurat atmosferike në Komunën e Gjilanit për çdo ditë janë më të pakta. Kjo qeverisje është duke menduar edhe për 20 vitet e ardhshme se çka do të ndodh? Ky vlerësim i dëmeve z. Rashiti ka qenë edhe në Komisionin për këtë rast dhe më sa më kujtohet në shkurt të vitit 2018 kam kërkuar nga z. Riad që të ma sjell Raportin e Lumit Mirusha, sepse ka qenë anëtarë i Komisionit, por nuk e ka sjell dhe ka thënë se nuk kemi mbajtur asnjë shënim.

Komisioni për Kompensimin e dëmeve ka marrë vendim dhe i kam 5 vendime e që keni shpronësuar njerëzit iu keni dhënë para mbi 25 mijë € (i ekspozon 5 vendimet), me të cilat mjete i keni shpronësuar muret, por kurrë nuk janë prekur ato mure. Të gjitha këto shkelje të cilat i keni bërë gjatë rregullimit të shtratit të Lumit Mirusha mund t’i marrësh me kërkesë zyrtare, kurse ndryshimet në projekt janë bërë me kërkesë të qytetarëve dhe për të mirën e tyre. Do ta shihni se si do të duket ky projekt dhe këto segmente si do të duken dhe do të ndërtohet edhe platoja të cilën ju e keni lënë në gjysmë te Hotel “Kristali.”

Do ta shohin qytetarët dhe ata do ta vlerësojnë dhe ne do ta marrim një vendim të qytetarëve dhe pas mbulimit të kësaj platoje, sepse jemi këtu me votë të qytetarëve për të mirën e tyre.

Riad Rashiti- kjo është për keqardhje dhe e turpshme që një prezantues i projektit tash zv/kryetar i Komunës, vjen shpif këtu dhe nuk merret me temën të cilën e ka prezantuar këtu, por merret me të kaluarën. Ne për dy vite kemi kërkuar disa herë rend të veçantë për raportim të Lumit Mirusha. Pse ky burrë i dheut, ky trim, ky hetues, ky prokuror që dy vjet nuk ka paraqitur shifra se gjëja kemi keqpërdorur dhe kemi shkelur ligjin. Tash ky po e arsyeton se ju e keni shkelur ligjin, prandaj edhe ne po e shkelim, por nëse ne e kemi shkelur mos e shkëlmoni ju !? Ju zv/kryetar nuk ke guxim as vendimin e protokolluar për ta lexuar. Çfarë nënkryetari jeni ju, kur vini dhe shpifni në KK të Gjilanit. Nuk u tha kostoja financiare e këtij ndryshimi në këtë projekt, sa kushton, duhet të thuhet shifra, sepse është obligim për ta prezantuar koston financiare të ndryshimit që p flasim për projekte me miliona €. Në qeverisjen e PDK-së kur është bërë ndryshimi ka prezantuar projektuesi me projektor, ka dhënë sqarime nga 2 orë. Ka prezantuar ndryshimet DUMM në këtë projekt, ka prezantuar edhe Komiteti i Urbanizmit. Ti nënkryetar tash dilini vetë. Cili është interesi i yt për ta prezantuar projektin? Interesi i yt është betoni, për të shit sa më tepër! Akuzove se raporti i vlerësimit nuk është prezantuar këtu, por kjo është rrenë e madhe z. Nënkryetar ! Si nuk po të vjen marre për të shpifur. Raporti i komisionit që kam qenë pjesë për vlerësimin e dëmeve që janë bërë dëmet për rrënim janë paguar të gjitha me kohë. Në atë Komision ka qenë i përfshirë edhe ish drejtori i Inspeksionit, Ismet Hajdini. Ky person e dinë a është raportuar dhe e dinë cili komision si ka punuar dhe e din Arben Mehmeti ish shef i grupit të LDK-së.

Te buxheti, nënkryetari po flet për të kaluarën, po flet pallavra, por në Qeverisjen e Hashim Thaçit janë investuar 3 milion € në këtë projekt, por në çdo rishikim të buxhetit të Qeverisë së Kosovës, Gjilani i ka marrë nga 2 milion € për këtë projekt.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika e renit të punës 2.1

Aprovohet pika 2.1. e rendit të punës: Kërkesë për ndryshimin e projektit për rregullimin e shtratit të Lumit Mirusha me 21 vota për, 4 kundër, kurse 4 nuk kanë votuar.

Pas kësaj pike të rendit të punës, anëtarët e Kuvendit shkojnë edhe në një pushim prej 10 min.

2.2 -Projekt – rregullorja mbi taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale për vitin 2016

Hevzi Matoshi- kjo rregullore është e bazuar në dispozitat e nenit 8 dhe 12 deri në 16 të Ligjit për financat e Pushtetit Lokal dhe në dispozitat e Statutit të Komunës së Gjilanit. Me këtë rregullore parashihet ndryshimi dhe plotësimi dhe harmonizimi i rregullores aktuale me dispozitat që preken shërbimet komunale, shërbimet në bujqësi sa i përket kontrollit të therjes së kafshëve dhe në kadastër. Në vijim të fjalës së tij z. Matoshi dha sqarime edhe më detale për këtë rregullore e të cilat sqarime anëtarët e KPF- së i posedojnë në materialet e tyre për këtë takim.

Për këtë rregullore është mbajtur edhe tubim publik dhe kërkesat e qytetarëve ishin që të hiqen taksat për bartjen e pronësisë në lagjen ish “Gavran”, sepse një pjesë e pronave ende figurojnë në emër të Komunës së Gjilanit.

Të hiqet tarifa sa i përket kërkesës formale sa i përket Komunës për blerje lidhur me transaksionet për shitblerjen e paluajtshmërive, ku dihet se Komuna asnjë kërkesë për blerje të paluajtshmërive të ofertuar nga ndonjë person nuk është blerë. Taksa 0.50 € për metër gjatësi si taksë për dhënie të pëlqimit të shfrytëzimit të hapësirës publike që ka të bëjë me shtrirjen e rrjetit ajror elektrik, telefonit, telekomunikacionit, TV-së dhe internetit propozohet që të hiqet. DSHP, ka propozuar të zbres nga 0.50 € në 0.20 € . Po ashtu është kërkuar që taksa të përfundojë si normal, shpërndarësve MDF për pagesë

mujore të bëhet ulja deri në ½ e vlerës së propozuar dhe tash është propozuar që kjo taksë të zvogëlohet nga 15 në 10 €. Për këtë arsyeje bazuar në këtë arsyetim dhe bazuar në nenin 58 pika “E” të LVL-së dhe në pajtim me nenin 77 nënparagrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Gjilanit i propozoj KK-së që në pajtim me rekomandimet në KPF dhe në pajtim me neni 40.2 pika “A” të LVL dhe të nenit 38 nënparagrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Gjilanit të aprovojë këtë rregullore me këto ndryshime për taksa, ngarkesa dhe gjopa komunale.

Avdyl Aliu- ashtu siç e dëgjua dhe duke parë se janë respektuar dhe plotësuar të gjitha procedurat dhe kriteret e nevojshme që kanë të bëjnë me ndryshimin e kësaj rregulloreje dhe me plotësim dhe duke u bazuar në LVL dhe në Statutin e Komunës, të gjitha këto janë në harmoni, prandaj ne si grup i LDK-së, iu ftojmë për t’i aprovuar këto plotësime dhe ndryshime të kësaj rregulloreje.

Arben Maliqi- unë e kam thënë edhe në KPF dhe kam kërkuar që të rishikohen disa taksa dhe ngarkesa për ushtrim të veprimtarive afariste të neni 4, faqe 4. Në këto nene, kur janë bërë dallime të pompave të benzinës kush është baza në qytet dhe fshatra, pse mos të bëjmë dallime edhe të restorantëve. Dihet se kemi restorante me 50 ulëse, 100 ulëse, por ka edhe me 500 ulëse. Unë mendoj se këtu e kemi bërë një diskriminim dhe duhet t’i kemi parasysh.

Ashtu është edhe të noterët, avokatët dhe përmblyesit privat, mendoj se është një shumë mjaft e vogël, sepse duhet pasur parasysh se dihet se çfarë fitimi kanë!

Riad Rashiti- ne këtë rregullore e kemi analizuar dhe shqyrtuar dhe i kemi vërejtjet tona sa i përket tarifave që janë propozuar në këtë rregullore. Ne kemi pritur nga kjo qeverisje në vitin e tretë të saj, kemi pritur që bizneseve t’ia lironi taksat dhe t’i hiqni në tërësi ashtu siç patëm vepruar në vitin 2012, por me ardhje të juaj në pushtet janë rikthyer ato dhe kemi rritje të taksave më të larta se sa kanë qenë derisa janë hequr. Për këto ndryshime të vogla që janë bërë në këtë rregullore në krahasim me të kaluarën, vërehet se te disa kategori ka rritje të vogla të taksave, por te disa kategori ka zbritje të taksave, sidomos të shërbimeve publike dhe për të cilat kisha kërkuar sqarime pse ka ndodhur kjo?

Ne si PDK në bazë të kontakteve që i kemi me bizneset, ata janë të pakënaqur dhe kanë ankesa serioze sa i përket kushteve të pafavorshme për biznes në Gjilan. Gjilani ka qenë Komunë shembull për kushte të mira për të bërë biznes dhe është shpërblyer nga USAIDI- Amerikan, kurse tash kjo gjendje ka ndryshuar për të keq.

Bizneset kanë ankesat për burokracinë dhe ankesat administrative që ballafaqohen me institucionet e Komunës së Gjilanit, sepse ka selektim të bizneseve disa favorizohen, kurse disa pengohen.

Si dëshmi për këtë që po e them për pengesë e kemi një peticion që nga muaji korrik nga pronarët e klinikave shëndetësore të cilët kanë kërkuar që të zvogëlohet kërkesa e tyre për zvogëlimin e taksave të bizneseve. Kjo kërkesë asnjëherë nuk është shqyrtuar dhe nuk ka marrë përgjigje nga këta pronarë.

Ne si PDK, kërkojmë nga Qeverisja Komunale që të hiqen të gjitha taksat për bizneset e vogla dhe të tariforen ato që kanë qenë sikur në rregulloren e vitit 2014. Po ashtu kërkojmë krijimin e lehtësirave të procedurave administrative për të gjitha bizneset në Komunën e Gjilanit.

Kam pyetje për zyrтарin ligjor : “ te nenin 2, pika 2.3 ku shihet se është zvogëluar tarifa për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të paasfaltuara dhe parqeve për 1 m² në 10 €. Unë nuk kam mund të orientohem qartë se në bazë të cilës rregullore janë bërë propozimet të vitit 2014 apo 2015? Unë pyes cila është arsyeja për këtë zbritje e cila zbritje arrin deri në 70%, sepse këtu bëhet fjalë për dëmtim të rrugëve?

Pas tarifës 12 të neni 2 pika 5, pas tarifës 12 shtohet tarifa e re me këtë përmbajtje: qarkullimin e ekraneve elektronike, reklamuese, lëvizëse nëpër qytet dhe qëndrimi në hapësirat publike”. Pika 12.1 tarifë ditore 1m², 2 €, ka qenë 5 €. Pse është ulur kjo tarifë, kur dihet që ato biznese janë profitabile?

Cilat janë arsyet pse te disa biznese po lirohen taksat, kurse te disa po ulen? Te pasuesi i 4, tarifa 6, radhitet pas tarifës 9 dhe teksti ka këtë përmbajtje” shfrytëzimi i hapësirës publike për pirje të duhanit,

objekt i përkohshëm montues, me pëlqim të DUMM” A është kjo rregullore në pajtim me Ligjin i cili e ndalon pirjen e duhanit, qoftë në objekte montuese, qoftë në ato të ndërtuara me material të fortë”?

Pyetja e fundit ka të bëjë për taksën për hyrje mujore në qytet për mjete transportuese për mallra komerciale dhe bartje të materialit ndërtimor mbi 3.5 ton e që është 200 €. Pra po flasim për mjete transportuese të cilat fusin material ndërtimi në qytet të Gjilanit e të cilëve iu ka pesëfishuar ulja e taksës. Ne e dimë që ndërtimet përveç që po bëhen pa leje, nuk paguajnë taksa dhe po e shkatërrojnë planin urbanistik dhe uzurpojnë pronë, tash ky propozim po vjen për t’i lehtësuar edhe këtë taksë të vogël për hyrje në qytet. A është kjo korrekte normale dhe në çka është bazuar?

Kërkoj përgjigje të saktë nga zyrtari ligjor në pyetjet të cilat i parashtrova.

Arijetë Rexhepi- në përgjithësi në këtë rregullore vërehet se janë ndryshuar disa taksa, ku në përgjithësi kishim dashur që t’i ndihmojmë bizneseve të vogla. Disa prej vërejtje që i kam janë këto: u tha për tarifën 43, 44 dhe 45 e të cilat thuhet se do të anulohen me arsyetim se duhet të ketë ankand për dhënie me qira të pronës komunale. Këtu flitet për objekte komunale me material të fortë ndërtimor, mandej për podrumet të cilat shfrytëzohen si lokale afariste, për depo për ngrohje qendrore, mandej edhe për objekte të përkohshme komunale etj. Në qoftë se parashihet që këto të shkojnë në bazë të ankandit, shtrohet pyetje ku do të mbesim me rregulloren e re? Çka do të ndodhin me ato që janë me qira dhe si janë të klasifikuara, sepse në mesin e tyre ka edhe depo për ngrohje qendrore. Pastaj në tarifën 37 shtohet edhe një pjesë ku thotë se do të bëhet edhe një leje për rregullimin e një varri nga familjarët e që do të kushtojë 10 €. Jam e mendimit se nuk ka qenë e nevojshme fare të merret leje për këtë çështje.

Gjithashtu edhe leje për hyrje në qytet me mjete transportuese për mallra komerciale dhe bartje të materialit ndërtimor më duket se ko ngarkesë është mjaft e vogël.

Hevzi Matoshi- së pari iu njoftoj se kemi të bëjmë me ndryshim dhe plotësim të rregullores, gjegjësisht nenit 5 të kësaj rregulloreje ku preket më së tepërmi nga tarifat dhe shërbimet që ofrohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Sa i përket pyetjes që ka të bëjë me nenin 4, në këtë procedurë për ndryshim të kësaj rregulloreje nuk ka ardhur për plotësim as nga drejtoria përkatëse, por as nga qytetarët. Ato janë tarifa që janë miratuar që nga viti i kaluar dhe janë në fuqi me këtë rregullore aktuale e cila është miratuar me ndryshim me 11 mars 2015.

U shtruan shumë çështje sa i përket tarifave që kanë të bëjnë me nenin 5, por të gjitha ato plotësime dhe ndryshime janë analizuar nga DSHP dhe në përputhje me sugjerimet dhe vërejtjet që i kanë pasur ata për aplikimin e tyre për një periudhë të caktuar, kanë ardhur në përfundim se disa nga tarifat bazë e që janë të caktuara me këtë rregullore të ndryshohen.

Ndryshimi ka të bëjë me zvogëlim, apo me riformulim të vetë titujve të këtyre tarifave. Kjo është arsyeja pse janë bërë disa ndryshime po e quaj tepër kozmetike.

Sa i përket tarifave që kanë të bëjnë me pronën komunale është ligji i cili e definon qartë procedurën e dhënise në shfrytëzim, prandaj të gjitha ato prona komunale të cilat janë në shfrytëzim e sipër dhe iu kalon kontrata, duhet të zhvillohet procedura e ankandit nëse mendojnë edhe më tutje për t’i shfrytëzuar. Ndryshimet që janë bërë në këtë rregullore janë ndryshime shumë të vogla që nuk e cenojnë ndryshimin e tërësishëm të rregullores dhe kemi të bëjmë me më pak se 40% të ndryshimeve. Në qoftë se do të kishim një ndryshim që kalon 40%, atëherë duhet propozuar një rregullore të re e cila do t’i nënshtrohet në tërësi plotësimeve dhe sugjerimeve që do të vijnë dhe nga dëgjimi publik. Obligim ligjor është që kjo rregullore çdo vit kalendarik të rishikohet, por nuk është e domosdoshme të ndryshohet.

Nuk pati debatuese të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.2 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.2 e rendit të punës: -Projekt – rregullorja mbi taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale për vitin 2016

me 20 vota për, 8 kundër dhe 2 abstenime

2.3 Plani – operativ emergjent për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera

Pika 2.3 me vendim të KK-së është hequr nga rendi i punës për këtë seancë.

2.4 Kërkesë për financimin e Manifestimit Mbarëkombëtar “Flaka e Janarit” 2016

Shpresë Kurteshi- manifestimi mbarëkombëtar “Flaka e Janarit” ndoshta i vetmi i kësaj natyre në trojet tona shqiptare, sigurisht që është madhështor, sepse këtë e tregon vetë fakti dhe historia që ajo brenda vetes e mban.

Ky manifestim i dedikohet heronjve tanë që nga epoka e lavdishme e Skënderbeut e deri te historia e jonë e lavdishme më e re. Mirëpo FLAKA e 2016 është më veçantë dhe si të tillë e bënë 25 vjetori i themelimit të saj dhe kemi të bëjmë me një vit jubilar të Flakës. Këshilli organizativ me kohë e ka dërguar projekt-propozimin e manifestimit në Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport e të cilin me mjaft kujdes e kemi shqyrtuar dhe e kemi propozuar për debat në këtë Kuvend.

Edhe këtë vit ky manifestim mbështet në 4 shtyllat e saj kryesore, të artit pamor, skenik, arti letrar dhe ai muzikor.

Mirëpo ka edhe risi që sjell Flaka e vitit 2016 dhe ajo është “Film-flaka” dhe motoja e Flakës është Festivali i Filmit i cili do të mbahet edhe si Festivali i Fotos.

Ne këto aktivitete i kemi vlerësuar mjaft pozitive dhe me këto do të begatohet Flaka duke i dhënë një madhësi këtij manifestimi. Në fund po theksoj se Këshilli organizativ ka bërë kërkesë në Ministri të Kulturës që financiarisht ta mbështesë Flakën, sepse janë tendencat që ky manifestim të hyjë brenda Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Shuma financiare prej 35 mijë €, Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport e ka parë të arsyeshme që kemi të bëmë me një vit jubilar dhe kemi të bëjmë me dy elemente mjaft të rëndësishme dhe kërkojnë mjete enkas për t’u realizuar, kemi parë të arsyeshme që të kërkojnë edhe mjete shtesë. Kërkoj që ky projekt të mbështet dhe të aprovohet propozimi i Këshillit organizativ.

Buar Nevzadi- pajtohem me fjalën hyrëse që e pat kryesuesja e komitetit, por i kam edhe disa sugjerime, por edhe ndonjë vërejtje. E para ky projekt na ka ardhur me vonesë dhe ka ardhur aty për aty. Ne e dimë që për 25 vite që “Flaka e Janarit” mbahet në Gjilan dhe është mbarëkombëtar dhe që nga fillimi kam qenë pjesë e këtij manifestimi.

Nën një para dy-tre vite ka qenë edhe një turnir i cili si fillim është mbajtur për nder të Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, por tash nuk e pashë se ky turnir është i paraparë.

Dy, ky projekt është i mangët, nuk dihet kur fillon dhe kur mbaron, datat dhe ditët.

Tre desha t’ia përkujtoj shefit të grupit të LDK-së se para disa vite i ka bërë disa vërejtje vazhdimisht se kemi shpenzuar shumë....? Mirëpo unë po i shoh disa gjëra që janë paraparë si moderatorët që duhet të paguhen, kokteji, në disa vende, mandej e keni thënë prezantuesi e keni ndryshuar nga moderatori, mëditje dhe në fund llogaria është 35 mijë €.

Unë nuk jam kundër dhe këtë e kam thënë edhe më herët, por edhe sot e them se dhe këto 35 mijë €, mendoj se për ta organizuar një Flakë të Janarit të mirë duhen mjete më shumë. Unë jam për ta votuar këtë përkundër vërejtjeve që i dhash.

Fehmi Sylejmnai- është për t’u çmuar festivali i “Flakës së Janarit”, sepse e dimë rëndësinë e këtij festivali i cili ka përmasa edhe më të gjëra, mirëpo rekomandimet dhe sugjerimet dhe vërejtjet që vazhdimisht i japim sërish nuk po përfillen. Për këtë arsyeje këtë festival po e bëjmë pak më të mangët dhe më të zbehët, sepse nuk po konsiderohen propozimet e mira dhe konkrete e të cilat do ta kishin begatuar këtë festival edhe më tepër.

Vitin e kaluar kanë qenë diku mbi 15 rekomandime që i kam dhënë dhe asnjë prej tyre nuk është marrë parasysh në këtë vit. E dyta prapë edhe këtë vit këtë festival po e mbajmë pa rregullore dhe nuk duhet të mbahet festivali pa rregullore.

E treta po mungon gjithmonë raporti i detajuar në fund të këtij festivali. Ky projekt i sotëm është i mangët, sepse mungon përshkrimi ose raporti narrativ nga vija buxhetore ose nga kodet buxhetore dhe këtu kemi vetëm shifra dhe nuk dihet se ku.

Nuk dihet se cila shtyllë, cilat data do t' i ketë dhe thuhet se fillon me 11 janar dhe përfundon me 31 janar dhe kjo tregon se ky material është vetëm një kopje e herëve të kaluara dhe asgjë nuk ka, përpos atyre risive që i përmendi parafolësja më herët. Mungesa e personave përgjegjës në këtë sallë dëshmon se nuk kanë qasje dhe nuk kanë ide se di duhet të organizohet ky festival. Mandej në secilin grup punues në pjesën financiare janë ndarë nga 600 €, por nuk janë të njëjtë secili grup, sepse disa shtylla kanë punë më shumë, kurse disa më pak, kurse të jetë linear pagesa kjo të jep për të kuptuar se dyshohet më vonë në çdo gjë. Mandej ka ligjërues, konferencier, moderator dhe janë disa vlera që nuk janë konstante e që duhet të jenë më të sakta. Për mendimin tim ky projekt ka nevojë të rishikohet dhe të ridizajnohet dhe të përpilohet edhe më mirë, sepse ky festival ka një rëndësi shumë të madhe në Gjilan dhe jashtë Gjilanit.

Avdyl Aliu- në emër të grupit të LDK-së foli, zonja Shpresë, por unë po përgjigjem për atë që e tha kolegu, Bujari dhe është fakt se unë kam folur për Flakën e Janarit, por më sa duket ai ka qenë viti 2011 dhe ka qenë një vit jubilar, por edhe ky vit është jubilar. Unë atëherë kam thënë se ka kushtuar shumë dhe atëherë ka kushtuar diku afër 76 mijë €.

Këtë vit po i njëjti festival për pa humbur në bërthamë dhe organizim, por veç çka është më mirë janë paraparë 35 mijë €.

Krahasoni 35 me 76 mijë, këtë kam deshtë ta them dhe asgjë tjetër.

Arben Maliqi- u tha se jemi koshient për rëndësinë e Flakës për të cilën vërtetë na kanë zili edhe shtetet jashtë regjionit, kurse mos të flasim për në Kosovë. Mirëpo një gjë te segmentet ku janë të përfshira arti pamor, ai skenik dhe ai letrar dhe muzikor, unë pyes se ku janë aktivitet sportive dhe ku janë garat sportive? Ne e dimë shumë mirë se para luftës janë zhvilluar gara të ndryshme si në fshatin Përlepnice, ku nuk duhet harruar garat në boks, kure në fushën "Selami Hallaçi" janë zhvilluar garat sportive në futboll të vogël, kur edhe e kemi ndaluar eksodin.

Krahas këtyre aktiviteteve, unë e shoh të arsyeshme që patjetër duhet të jenë edhe aktivitetet sportive dhe garat sportive.

Ky është një sugjerim për të gjitha ata që e kanë përpiluar këtë projekt, por ende nuk është vonë që të parashihet edhe ndonjë garë sportive.

Izmi Zeka- së pari po e them se gjuhësisht nuk është askund ky projekt, sepse ka gabime shumë. E dyta hiqeni këtë DKRS që po figuron këtu, sepse nuk ka drejtori ju e dini. Këto janë aspekte teknike, por mbesin si pasqyrë e kulturës sonë drejtshkrimore. Një çështje tjetër po më vjen mirë se gradualisht po kuptohet se më nuk bëhet pa para asgjë. Aspekti tjetër është që ne 76 mijë € nuk i kemi harxhuar asnjëherë. Është mirë të hulumtohen statistikat, por unë e kam një bindje se nëse janë paraparë 35 mijë €, në fund do t' i dalin 45, mijë ose më tepër, sepse na dalin gjëra të paplanifikuara.

Harxhime ka, sepse edhe konferencieri duhet të paguhet, sepse nuk ka punë më me aspekt vullnetar.

Edhe një që dua ta di është se kush është Këshilli organizativ dhe kush janë emrat?

Është mirë që janë dy risi dhe është gjithashtu e mirë që çdo vit të ketë ndonjë risi dhe u tha nga Bujari se ne e mbështesim, por iu lutem që këto gabime teknike dhe gjuhësore të eliminohen dhe mos të mbetët në arkiv një dokument me gabime këtilla.

Sadullah Kadriu- është mirë që ky manifestim u tha se është mbarëkombëtar e që për dëshminë dhe punën që ka bërë deri më tash nuk kemi arsye të flasim, sepse ka bërë jehonë jashtëzakonisht të madhe.

Mirëpo edhe vitin e kaluar kemi kërkuar dhe ka qenë iniciativa që nëse quhet manifestim mbarëkombëtarë, pse nuk insistohet që të realizohet ndonjë segment i këtij manifestimi të realizohet edhe në Luginën e Preshevës. Vitin e kaluar për 300 € ka mbetur për pa u realizuar kjo iniciativë.

Për këtë arsyeje kërkoj nga Këshilli iniciativë që ta shikojë mundësinë që në dy qytete Preshevë dhe Bujanoc të realizohet diçka nga arti skenik, ose ndonjë degë tjetër e artit, ose pikë muzikore.

Serbia bën edhe gara në shtetin tonë, pse ne nuk e shikojmë mundësinë për të dërguar diçka artistike e që është shumë vlefshme për ata banorë të këtyre qyteteve.

Nevzad Isufi- unë e kam vetëm një vërejtje e cila është dhënë edhe vitin e kaluar e që do të thotë që rreth lëvizjeve të datave kur të filloj manifestimi mos të lëshohen ato që veç janë bërë traditë. Gjithashtu edhe unë jam për atë se cili është Këshilli organizativ dhe nga sa anëtarë përbëhet i cili Këshill duhet të ketë një gjithë përfshirje dhe të ruhet ngjyra e manifestimit ashtu siç është tradicionalisht dhe të mos i epet kahe tjetër.

Shpresë Kurteshi- Këshilli organizativ përbëhet nga 8 anëtarë, dhe i ka 6 nëngrupe e të cilat janë:

Anëtarët e Këshillit organizativ të udhëhequr nga Lutfi Haziri janë Arbër Ismaili, Kujtim Shahiqi, Bujar Haziri, Nazim Gatica, Ali Demi, Ibrahim Ademi dhe Bashkim Nexhipi.

Grupi punues i artit skenik: Ali Demi, Avni Shkdra dhe Tringa Hasani

Grupi punues për art pamor: Luan Shahiqi, Avni Behluli, dhe Qamil Llapashtica

Grupi punues i artit letrar: Sabit Rrushemi, Xhevat Latifi dhe Albina Idrizi.

Grupi punues për artin muzikor; Orhan Azizi, Bekim Rexhepaj, Murat Ismajli, Jushtim Jakupi dhe Adhurim Rasimi.

Grupi punues për filmin e shkurtër dhe fotografi: Burim Baftiu, Eroll Jonuzi dhe Ardina Dubova.

Grupi punues për informim: Muhamet Pajaziti, Pemptim Latifi, Exhevit Rexhepi dhe Dren Emini

Zonja Shpresë theksoi se sa i përket programit të manifestimit të gjitha detaje i posedoj dhe të cilat i lexoi para anëtarëve të Kuvendit.

Bujar Nevzadi- nuk pajtohem me Bordin e Flakës së Janarit, sepse që kur ka filluar ky manifestim asnjëherë nuk ka pasur Bord politik, kure ky i këtij viti është në tërësi Bord politik. Kërkoj që t' i lehet hapësirë edhe subjekteve tjera dhe kërkoj që të futen përfaqësues në Bord edhe të subjekteve tjera politike (njerëz të kulturës dhe jo politik)

Leonorë Bunjaku- qeverisja aktuale po vazhdon ta përsëris të njëjtin gabim në çdo këshill edhe atë duke filluar nga drejtoritë komunale. A nuk ka asnjë femër që meriton për të qenë në atë këshill? Deri kur ky diskriminim gjinor? Ju lutem ju jeni ata që i keni propozuar, prandaj shqyrtoni edhe njëherë këtë propozim?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- kjo ishte vërejtje shumë me vend, por problemi qëndron në atë se këtë Këshill e ka emëruar ekzekutivi, kurse ne nuk kemi pasur qasje në këto propozime.

Fehmi Sylejmnai-kjo përbërje, ky komision është me ngjyrë shumë politike dhe më së keqi i qëndron Flakës së Janarit, kur ka një përbërje kështu me ngjyrë politike. Është mirë që ky Bord të korrigjohet dhe të futen emra eminent që i ka Gjilani, sepse nuk janë vetëm këta emra në parti.

Arben Mehmeti- ajo që e pash unë, këta emra nuk llogariten pjesë politike, por ata janë pjesë administrative dhe ekzekutive. Edhe politike mund të quhen me një aspekt, sepse zgjedhjet i ka fituar dikush tjetër krahasuar me të kaluarën. Përndryshe emrat që u theksuan ata janë njerëz profesional që janë marrë me këtë fushë.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.4 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.4 e rendit të punës: Kërkesë për financimin e Manifestimit Mbarëkombëtar “Flaka e Janarit” 2016, me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, 5 kundër dhe 1 abstenim, 2 nuk ishin pjesë e votimit.

4. Plani i punës së Kuvendit dhe orari i takimeve të Kuvendit

Valentinë Bunjaku- Rexhepi - kjo pikë është ardhur pak me vonesë, por grupi punues është pajtuar që të futet në këtë seancë dhe të starojmë me punë të Kuvendit sipas orarit të planifikuar.

Isa Agushi- unë e kam gjetur një vërejtje tek pika 7 për orarin e takimeve dhe Komitetin për Shërbime Publike ku unë jam kryesues, është edhe Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim. Këtu janë dy drejtori me një komitet.

Nevzad Rushiti- unë ne emër të Komisionit i cili është zgjedhur, së bashku e kemi hartuar këtë plan dhe orar dhe mendoj se është mjaft i saktë duke u munduar që të përfshihen shqyrtimi i të gjitha rregulloreve dhe pikave të rendit të punës që të debatohen në kohën e duhur. Si shembull është se në shkurt ka mbetur që të bëhet raporti për Flakën e Janarit, kurse për komitetet ka qenë e paraparë që çdo tre muaj të raportohet, por ne kemi propozuar që kjo të bëhet në çdo gjashtë muaj dhe në fund të vitit.

Jakup Bajrami- këtu në Plan është paraparë, Raporti i kryetarit në fund të vitit 2015. Unë mendoj se ky raport për kryetarin dy herë epet në vit, do të thotë çdo gjashtë muaj dhe jo në fillim të vitit.

Fehmi Sylejmani- ky Plan i punës në shikim të parë si dizajn shihet se është i mirë, mirëpo te vendimet është mirë të futet projekt-vendimet, sepse ka projekte dhe vendime, kurse një kolon duhet të jetë: “aktivitetet”. Tek aktivitetet përshihen takimet e ndryshme me qytetarë ose takimi Solemn për Ditën e Pavarësisë etj. Unë i kam shikuar disa gjëra që janë paraparë, por po vërej se Komisioni e ka dorëzuar si të tillë, sepse po thuhet se është si ide, kurse më vonë mund të plotësohet.

Unë kam propozim për shumë pika të rendit të punës që duhet të përfshihen në këtë plan dhe nëse keni durim po filloj për t’i lexuar: Nëse mendoni që të kalojë ashtu si është, unë mendoj se nuk është Plan i punës ashtu si duhet.

E para KPF duhet të shqyrtojë realizmin e planeve vjetore të drejtorive dhe zyrave komunale.

KPF, çdo tre muaj të shqyrtojë realizimin e Planit të punës së KK-së.

Mandej mungon raporti i shërbimit me qytetarë për vitin 2015.

Raporti përfundimtar për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare për vitin 2015.

Në vijim të fjalës së tij, z. Sylejmani pati edhe shumë propozime, por hoqi dorë nga propozimi i mëtejshëm, sepse nuk kishte të interesuar për t’u përfshirë shumë pika që i propozoi z. Sylejmani.

Shukrie Rapuca- edhe unë e kam lexuar, Planin e punës së KK të Gjilanit i cili si plan më pëlqeu e thash përmbajtjen e disa planeve që do të realizohen gjatë seancave në vijim dhe asgjë nuk kam për t’i shtuar përveç një propozimi që e kam:

Propozoj që secilën seancë të shqyrtohet nga një raport i një drejtorie me radhë dhe deri në fund të vitit mund të përfshihen të gjitha raportet. Raportet e kryetarit po shihen, por raporti i kryetarit është përmbledhës, prandaj është në dobi tonën dhe të qytetarëve për ta përfshirë edhe këtë propozim.

Gjatë fjalës sime dëgjova se pati pajtime me propozimin tim, prandaj mendoj se edhe drejtorët do të pajtohen që ky propozim të përfshihet në Planin e punës së Kuvendit.

Leonorë Bunjaku- edhe unë shoh të arsyeshme që duhet patjetër nga një raport, sepse ai do të na ndihmonte edhe neve, por edhe drejtorët, sepse do të kenë mundësinë për t' i përmirësuar mangësitë e tyre. Gjithashtu i lus, kryesuesin e Komitetit të Arsimit që t' i ketë parasysh propozimet të cilat i kemi dhënë ne si opozitë, sepse edhe aty e kanë pranuar se kanë qenë shumë frytdhënëse ato pika. Për këtë arsyeje iu lus që t' i keni në konsideratë dhe t' i inkorporoni aty ku është e nevojshme sipas planit dhe orarit të punës së KK-së. Ne edhe me shkrim i kemi dorëzuar këto propozime dhe besoj se do t' i keni në konsideratë.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi - së pari po i propozojmë për aprovim edhe disa pika plotësuese të cilat i propozoi z. Sylejmnai e që ishte një numër i madh i pikëve të rendit të punës, prandaj iu lus të deklaroheni se kush është që të përfshihen edhe këto pikë të rendit të punës, nga z. Sylejmnai?

Për propozimin e z. Sylejmani ishin 8 anëtarë të Kuvendit, kundër ishin 18, 1 abstenim dhe 2 nuk morën pjesë në votim dhe nuk u aprovua propozimi i z. Sylejmani.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 4 e rendit të punës, me vërejtjet e dhëna dhe me plotësime të që u dhanë nga anëtarët e KK-së.

Aprovohet pika 4 e rendit të punës: Plani i punës së Kuvendit dhe orari i takimeve të Kuvendit, me vërejtje dhe plotësime që u dhanë nga anëtarët e Kuvendit, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, 3 kundër, kurse të tjerët nuk morën pjesë në votim.

Të ndryshme –

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- në këtë pikë do të jep përgjigje drejtori i DKA-së, z. Nazmi Musa, kurse debati për pikën nën të ndryshme u shter qysh në fillim të seancës, kurse për seancat e tjera kërkesat që i keni për këtë pikë i dërgoni me shkrim.

Nazmi Musa- z. Musa dhe përgjigjet mjaft të gjatë përkritazi me një vizitë të cilën e ka pasur në Turqi. e cila çështje ishte debatuar edhe në Komitetin për Arsim, por edhe kryetari i Komunës ishte informuar me kohë.

Në vijim të fjalës së tij z. Musa e lexoi të tërë informatën e cila iu ishte dërguar kryetarit me datë 27.8.2015

Renan Imami- është hera e dytë që bëni vizitë në Turqi dhe nuk njoftohemi se kush janë zyrtarët që kanë marrë pjesë në këto vizita?

Nazmi Musa -nuk është hera e dytë, por është e para dhe nuk është se kemi anashkaluar përfaqësuesin e komunitetit turk, por nuk kemi pasur thirrje me përcaktime kombëtare, sepse kemi shkuar si mysafirë profesional të shkollave që i kemi vizituar. Gjatë vizitës në Turqi jemi ndarë shumë të kënaqur, por ata ishin edhe më të kënaqur se si ne e trajtojmë komunitetin turk, sepse askund dhe as në Turqi nuk ka që një nxënës ta ketë një mësues, kurse kjo është duke ndodhur në KK të Gjilanit. Ne kemi kontakte të shpeshta me KFOR-in turk dhe presim ndihma dhe bashkëpunim reciprok edhe më të madh.

Me këto debate dhe vendime seanca e dhjetë i përfundoi punimet në ora 14.40

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjku- Rexhepi